

Në akademinë solemne “Faleminderit Shqipëri”, Prishtinë



Në përkujtim të 21-vjetorit të mikpritjes së Shqipërisë gjatë eksodit të popullit të Kosovës në vitin 1999, Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, mori pjesë në akademinë solemne “Faleminderit Shqipëri” në Prishtinë. “Në ato ditë të vështira përcaktuam se kush jemi, nga vijmë dhe se ku duam të shkojmë. Në ato momente të vështira, të gjithë shqiptarët u bëmë një. Më 1999, ne kuptuam që nuk bëjmë pa njëri-tjetrin, nga ajo kohë ne kemi filluar një udhëtim të përbashkët”, u shpreh ministri Majko. Këtë akademi solemne e përshëndeti edhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, të cilët falënderuan dhe vlerësuan solidaritetin dhe bujarinë e popullit shqiptar në një vit jashtëzakonisht të vështirë për kombin tonë.

Zhvillohet mbledhja e parë e Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2020



Këshilli Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Diasporës ka mbajtur mbledhjen e parë për vitin 2020, e cila u drejtua nga kryetari i këtij këshilli, z. Etjen Xhafaj, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gjatë mbledhjes së sotme u prezantua programi i aktiviteteve të planifikuara për t’u zbatuar gjatë këtij viti nga Agjencia. Në përfundim të diskutimeve Këshilli Drejtues miratoi Programin e Aktiviteteve të Agjencisë Kombëtare të Diasporës për vitin 2020.

Agjencia Kombëtare e Diasporës publikon Raportin Vjetor për vitin 2019

RAPORTI VJETOR

AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS



Raporti është një përmbledhje e funksioneve dhe aktiviteteve institucionale të realizuara nga Agjencia dhe shërben për të informuar institucionet përkatëse rreth veprimtarisë dhe arritjeve të Agjencisë gjatë 2019-ës si dhe prezantimi i parashikimit të zbatimit të aktiviteteve gjatë 2020-ës. Disa prej çështjeve kryesore të trajtuara në raport janë: statusi ligjor i Agjencisë Kombëtare të Diasporës; struktura e institucionit dhe realizimi i buxhetit për vitin 2019; aktet ligjore të miratuara; aktivitetet institucionale; si dhe pasqyra financiare për 2019-ën dhe 2020-ën.

KKD / Mark Gjonaj në Shkollën Shqipe “Alba Life” në New York




Reportazh mbi veprimtarinë e shkollës shqipe “Alba Life”, Ambasador i Kombit”, në New York të SHBA-së. Pjesë e reportazhit të realizuar nga “Alba Life TV” është edhe vizita e Kryetarit të Këshillit Koordinues të Diasporës dhe Këshilltar në Këshillin Bashkiak të New York-ut, z. Mark Gjonaj, në këtë shkollë.

KKD / Gazmend Kapllani vlerëson figurën e Van Christo-s

Ndahet nga jeta Van Christo, një nga udhëheqësit e komunitetit shqiptar në Amerikë si përkushtuar për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit shqiptar edhe në kushtet e ndërprerjes së plotë të komunikimit me atdheun e origjinës, Shqipërinë. Shkrimtari i njohur me banim në Amerikë dhe anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës Gazmend Kapllani, përmes një shkrimi ka vlerësuar figurën dhe kontributin e madh të Van Christo-s. “...Një njeri poliedrik, biznesmen, piktor, dirigjent i orkestrave simfonike në Boston dhe drejtues i korit të kishës ortodokse shqiptare, Van Christo dhe bashkëshortja e tij, gazetare e shquar amerikane, Jane Christo kanë ndihmuar shumë emigrantë shqiptarë që mbërritën në Amerikë pas viteve '90. Personalitete të tilla duhet të mbeten të paharruar në kujtimin tonë...”, shprehet për të Kapllani.



Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

“Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin “e-Albania”.